REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA
ZYRA E KRYEMINISTRIT - URED PREMIJERA - OFFICE OF THE PRIME MINISTER
SEKTORI I ARKIVËS - SEKTOR ARHIVE - ARCHIVE SECTOR

[illegible] 01    Nr. Prot. / Br. Pr. / Prot. No. 1059/15

[illegible] -PO-    Data: / Datum: / Date 10/04/2018

Prishtinë/a

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada – Government*
*Ministria e Zhvillimit Rajonal*
*Ministarstvo za Regionalni Razvoj*
*Ministry of Regional Development*

# *RAPORTI 100 DITOR I PUNËS SË ZËVENDËS MINISTRIT TË ZHVILLIMIT RAJONAL, z. ESAT RACI*

Prill, 2018

## Raporti i Punës së Njëqind ( 100 ) Ditëshit të Parë të vitit 2018, Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci.

- ✓ Zëvendës Ministri i zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, përgjatë takimit me Ministrin z. Rasim Demiri, zëvendës ministrat znj. Magbule Shkodra, z. Musa Cena si dhe U.D sekretar i përgjithshëm z. Besim Kamberaj, ka rekomanduar si prioritetet kryesore të MZHR - së për këtë vit: Investimet kapitale dhe subvencionet për komuna dhe bizneset private, funksionalizimi dhe kompletimi me staf përmes organogramit të ri të MZHR - së, si dhe akomodimi i stafit politik në një objekt së bashku me stafin civil.

- ✓ Zëvendës Ministri i zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, ka kërkuar qasje sa më bashkëpunuese me kryetarët e komunave të Republikës së Kosovës, në mënyrë që të arrijmë synimet dhe objektivat e MZHR – së, për të ngritur mirëqenjen e qytetarëve të vendit.

- ✓ Zëvendës Ministri i zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, me qëllimit të bashkëpunimit mes nivelit lokal dhe atij qendror, ka vizituar komunat e : Hanit të Elezit, Kaçanikut, Shtimes, Klinës, Istogut, Drenasit dhe Skenderajit, ku është takuar me krerët e këtyre komunave, duke prezantuar programin politik të MZHR – së, si dhe duke inkurajuar bashkëpunimin reciprok për të ndihmuar jetën e qytetarëve.

- ✓ Ministria e Zhvillimit Rajonal, ka hartuar udhëzimin, Skema e Granteve, Programi për zhvillimin rajonal të balancuar MZHR / 2018.

- ✓ Zëvendës Ministri i zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, me qëllim të lansimit të Programit për zhvillimit rajonal, së bashku me Ministrin z. Rasim Demiri, Zëvendës Ministrat, znj. Magbule Shkodra dhe z. Musa Cena, të prirë nga kryeministri,z. Ramush Haradinaj, organizuan takim me kryetarët e komunave dhe përfaqësuesit e tyre. Në këtë takim MZHR informoi komunat lidhur me përmbajtjen e programit për zhvillimin rajonal, si mundësitë që i ofron ky program për skemat e granteve dhe investimet kapitale ku përfituese do të jenë komunat, me vlerë të përgjithshme prej dy ( 2 ) Milion Eurove.

- ✓ Zëvendës Ministri i zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, gjithashtu në vazhdimësi ka informuar krerët e komunave lidhur me programin politik të MZHR – së, format e aplikimit, kriteret e përzgjedhjes, afatet e aplikimit dhe realizimit të projekteve.

- ✓ Zëvendës Ministri i zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, në vazhdimësi ka inkurajuar të gjitha komunat për aplikim në projektet e ofruara nga MZHR, si mundësi reale për të ngirtur mirëqenien e qytetarëve të vendit.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal z. Esat Raci, përgjatë takimit konsultativ me Ministrin z. Rasim Demiri, zëvendës ministrat, znj. Magbule Shkodra dhe z. Musa Cena, dhe U.D sekretari i Përgjithshëm I MZHR –së z. Besim Kamberaj, kërkoi të ofrohet qasje gjithëpërfshirëse dhe e barabartë për të gjitha komunat aplikuese për skemën e granteve të ndara nga MZHR. Gjithashtu, respektim të kritereve të përcaktuara nga MZHR dhe inkurajim për të fituar projektet më të mira, që ofrojnë lehtësira për qytetarët e atyre komunave.

- ✓ Zëvendës Ministri i zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, në kuadër të lansimit të Skemës së Granteve, " Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar ", në Prishtinë, së bashku me Ministrin, z. Rasim Demiri, zëvendës Ministrat znj. Magbule Shkodra dhe z. Musa Cena, organizuan prezantimin e Sesionit informues për Rajonin Qendra, me Përfituesit potencial/bizneset me qëllim të informimit lidhur me programin, aplikimin, kriteret dhe përzgjedhjen e fituesve. U Theksua se shuma e fondit në vlerën 1,400,000.00 euro është e orientuar në projekte që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, së bashku me zëvendës ministren znj. Magbule Shkodra, u takuan me kryetarin e komunës së Pejës z. Gazmend Muhaxheri. Përgjatë takimit, kryetari Muhaxheri, u njoftua për programin politik të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, dhe u inkurajua për të pasur bashkëpunim dhe koordinim, përmes cilës do të ndikoj pozitivisht për gjithë qytetarët.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, së bashku me zëvendës ministren znj. Magbule Shkodra, vizituan Agjencionin e Zhvillimit Rajonal - Perëndim, ku u mirëpritën nga Drejtoresha znj. Lemane Hatashi. Zëvendës Ministri, z. Raci, përgëzoi për punën e këtij agjencioni, dhe ftoi për vazhdimin e bashkëpunimit mes MZHR – së dhe Agjencioneve të Zhvillimeve Rajonale.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, së bashku me Ministrin z. Rasim Demiri, zëvendës ministrat z. Musa Cena, znj. Magbule Shkodra dhe U.D sekretar I përgjithshëm z. Besim Kamberaj, pritën delegacionin e komunës së Kaçanikut, prirë nga kryetari I Komunës z. Besim Ilazi. Ministria e Zhvillimit Rajonal nga komuna e Kaçanikut , pranoi projekt dorëzimin e parë për aplikim në skemën e granteve nga MZHR për investimet kapitale.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, priti në takim, delegacionin e komunës së Klinës, me të cilët diskutuan lidhur me projektet e MZHR –së. Delegacioni nga Klina, falenderoi për inkurajimin dhe paraqiti projektin me të cilën synojnë të përfitojnë nga skema e granteve të MZHR –së për investime kapitale, përmes së cilës do të mundësojnë ofrimin e lehtësirave për jetën e përditshme të qytetarëve.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, dhe zëvendës ministrja znj. Magbule Shkodra, pritën në takim kryetarin e komunës së Hanit të Elezit, z. Refki Suma, I cili u falenderua nga nikoqirët për vizitën e realizuar. Z. Suma bëri dorëzimin e projektit në MZHR. Gjithashtu i garantuan qasje bashkëpunuese së bashku me të gjitha komunat tjera. Kryetari Suma falenderoi për pritjen dhe u zotua se do te vazhdoj bashkëpunimin me MZHR – në.

- ✓ Ministria e Zhvillimit Rajonal, ka hartuar Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe për sistematizimin e vendeve të punës.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, në kuadër të vizitës zyrtare në Republikën e Shqipërisë, së bashku me zëvendës ministrat, znj. Magbule Shkodra dhe z. Musa Cena, vizituan Ambasadën e Republikës së Kosovës, ku u pritën nga I ngarkuari me punë në Ambasadën e Kosovës në Tiranë z. Sylë Ukshini me të cilin bashkëbiseduan rreth programit të MZHR –së si dhe nevojën e afirmimit të kësaj ministrie të re të Republikës së Kosovës.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, së bashku me zëvendës ministrat, znj. Magbule Shkodra dhe z. Musa Cena, u takuan në Tiranë me me Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, z. Engjëll Agaci dhe me Zv.Sekretaren e Përgjithshme të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, znj. Majlinda Dhuka. Delegacioni nga MZHR – ja, informoi mbi programin politik të saj, dhe kërkoi që Kosova të ndihmohet në aspektin e zhvillimit rajonal pasi që Shqipëria ka përvojë në këtë drejtim. Të dy palët u dakorduan dhe rikonfirmuan bashkëpunimin për këtë proces, ashtu sikurse për fushat tjera dhe për shkëmbimin e përvojave mes Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, së bashku me zëvendës ministrat, znj. Magbule Shkodra dhe z. Musa Cena, u takuan në Tiranë me drejtorin e Agjencisë së Zhvillimit Ekonomik (AZHER), z. Rezar Sako, me të cilin u dakorduan për koordinime të përbashkëta në mënyrë që të ketë bashkëpunim të frytshëm për të realizuar programe që janë në interes të qytetarëve të dy vendeve tona.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, së bashku me zëvendës ministrat, znj. Magbule Shkodra dhe z. Musa Cena, u takuan në Tiranë me drejtorët e Agjensive të Zhvillimit Rajonal për Shkodrën dhe për Tiranën, z. Shpëtim Quku dhe z. Arben Skënderaj. Të dy palët u informuan mbi procesin e zhvillimeve rajonale tek dy vendet, tek organizimi dhe politikat e ofruara si dhe u pajtuan që të kenë organizime të përbashkëta në mënyrë që të ofrojnë hapësira më të përshtatshme për qytetarët e të dyja vendeve.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal z. Esat Raci, përgjatë takimit konsultativ me Ministrin z. Rasim Demiri, zëvendës ministrat, znj. Magbule Shkodra dhe z. Musa Cena, si dhe U.D sekretari i Pergjithshëm I MZHR –së z. Besim Kamberaj, kërkoi të respektohen në përpikëmëri kriteret e përcaktuara nga MZHR, për përcaktimin e projekteve fituese të granteve të MZHR – së që ndahen për biznese private. Gjithashtu besoi se do të bëhet përzgjedhja meritore për projektet që ofrojnë ngritjen e punësimit dhe zhvillimit të bizneseve, që është dhe kryefjala e ekzistencës së Ministrisë së Zhvillimit Rajonal.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, së bashku me Ministrin z. Rasim Demiri, zëvendës ministrat znj. Magbule Shkodra dhe z. Musa Cena, morrën pjesë në ceremoninë e organizuar nga FSK – ja, për nder të Marsit të Lavdishëm të Epopesë së UÇK – së.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, me ftesë të kryeministrit të Republikës, z. Ramush Haradinaj, së bashku me ministrin z. Rasim Demiri, zëvendës ministrat, znj. Magbule Shkodra dhe z. Musa Cena, bënë homazhe tek varrezat e dëshmorëve në Prekaz, për nder të njëzet vjetorit të rënjes heroike të komandandit lexhendar Adem Jashari dhe familjes heroike Jashari.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, për nder të 7 Marsit, ditës së mësuesit, u takua me mësimdhënës nga komuna e Klinës, ku uroi për ditën e tyre, falenderoj për punën dhe përkushtimin ndaj arsimit shqip si dhe gjithashtu uroi suksese për të gjithë.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal z. Esat Raci, së bashku me Ministrin z. Rasim Demiri, zëvendës ministrat, znj. Magbule Shkodra dhe z. Musa Cena, u njoftuan nga U.D sekretari i Përgjithshëm i MZHR –së z. Besim Kamberaj, mbi përzgjedhjen e projekteve fituese për ndarjen e granteve nga MZHR, për komunat në projektet e tyre për investimet kapitale.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, priti në takim, një grup studentësh që studiojnë në shtetet Perëndimore. Përgjatë diskutimit dhe bisedave të përbashkëta, zëvendës ministri informoi mbi programin politik të MZHR – së, dhe bazën e ndarjes në pesë qendra të vendit si mundësi për zhvillim e që në realitet është marrë si model pikërisht politikat e BE – së. Studentët u inkurajuan që të promovojnë vendin tonë aty ku ata jetojnë dhe studiojnë dhe gjithashtu të kthehen për të kontribuar në proceset e vendit, pas diplomimit të tyre.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, me qëllim të bashkëveprimit dhe shkëmbimit të përvojave është takuar me zëvendës ministrin e Inovacionit dhe ndërmarrësisë z. Bujar Cakolli, me zëvendës ministrin për komunitete dhe kthim z. Florent Hoxha si dhe me zëvendës ministrin e Punës dhe mirëqenies sociale z. Abyl Imeri.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, zhvilloi takim konsultativ me Ministrin z. Rasim Demiri, zëvendës Ministrat znj. Magbule Shkodra, z. Musa Cena, dhe sekretari i përgjithshëm z. Fatos Qerimi. Zëvendës Ministri z. Raci, edhe njëherë potencoi nevojën e ambientimit të të gjithë stafit të MZHR – së në një objekt të përbashkët. Gjithashtu kërkoi që sa më parë të nenshkruhet marrëveshja me kryetarët e komunave fituese të granteve për investimet kapitale, të ndara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, në mënyrë që të hecim përpara me projektet e realizuara ku do të lehtësohen problemet dhe jetesa e qytetarë

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, për nder të 7 Marsit, ditës së mësuesit, u takua me mësimdhënës nga komuna e Klinës, ku uroi për ditën e tyre, falenderoj për punën dhe përkushtimin ndaj arsimit shqip si dhe gjithashtu uroi suksese për të gjithë.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal z. Esat Raci, së bashku me Ministrin z. Rasim Demiri, zëvendës ministrat, znj. Magbule Shkodra dhe z. Musa Cena, u njoftuan nga U.D sekretari i Përgjithshëm i MZHR –së z. Besim Kamberaj, mbi përzgjedhjen e projekteve fituese për ndarjen e granteve nga MZHR, për komunat në projektet e tyre për investimet kapitale.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, priti në takim, një grup studentësh që studiojnë në shtetet Perëndimore. Përgjatë diskutimit dhe bisedave të përbashkëta, zëvendës ministri informoi mbi programin politik të MZHR – së, dhe bazën e ndarjes në pesë qendra të vendit si mundësi për zhvillim e që në realitet është marrë si model pikërisht politikat e BE – së. Studentët u inkurajuan që të promovojnë vendin tonë aty ku ata jetojnë dhe studiojnë dhe gjithashtu të kthehen për të kontribuar në proceset e vendit, pas diplomimit të tyre.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, me qëllim të bashkëveprimit dhe shkëmbimit të përvojave është takuar me zëvendës ministrin e Inovacionit dhe ndërmarrësisë z. Bujar Cakolli, me zëvendës ministrin për komunitete dhe kthim z. Florent Hoxha si dhe me zëvendës ministrin e Punës dhe mirëqenies sociale z. Abyl Imeri.

- ✓ Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal, z. Esat Raci, zhvilloi takim konsultativ me Ministrin z. Rasim Demiri, zëvendës Ministrat znj. Magbule Shkodra, z. Musa Cena, dhe sekretari i përgjithshëm z. Fatos Qerimi. Zëvendës Ministri z. Raci, edhe njërë potencoi nevojën e ambientimit të të gjithë stafit të MZHR – së në një objekt të përbashkët. Gjithashtu kërkoi që sa më parë të nenshkruhet marrëveshja me kryetarët e komunave fituese të granteve për investimet kapitale, të ndara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, në mënyrë që të hecim përpara me projektet e realizuara ku do të lehtësohen problemet dhe jetesa e qytetarëve.

*I Nderuari Kryeministër i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj.*
***Bazuar në Vendimin Nr. 171/2017, me datë 07.11.2017, për emërimin tim si zëvendës ministër i zhvillimit Rajonal të Republikës së Kosovës. Raporti im i Punës së njëqind ditëshit të parë të vitit 2018, si Zëvendës Ministër i Zhvillimit Rajonal, ka për qëllim të kontribuojë në krijimin e kushteve për zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm dhe për të promovuar zhvillimin socioekonomik, mjedisor, kulturor dhe të balancuar të Republikës së Kosovës.***

***Me respekt***

***Zëvendës Ministri i Zhvillimit Rajonal***
***z. Esat Raci***